Albania ألبانية

3 LLojet e Teuhidit

Veçimi i Allahut, të Madhëruar, në ato që i atribohen vetëm Atij, në Rububije (se vetëm Atij i takon krijimi, zotërimi, drejtimi i çdo gjëje), në Uluhije (se vetëm Atij i takon adhurimi, madhërimi), dhe në Esma ue Sifat (se vetëm Atij i takojnë Emrat dhe Cilësitë më të Larta).

LLojet e tij janë tre

Teuhidi Esma ue Sifat

Veçimi i Allahut, të Madhëruar, në ato që Ai e ka emërtuar dhe cilësuar Veten e Tij, në Librin e Tij, ose nëpërmjet fjalës së të Dërguarit të Tij, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, duke pohuar ato të cilat, Allahu i Lartësuar i ka pohuar për Veten e Tij dhe të mohojmë ato që ka mohuar për Veten e Tij, pa i ndryshuar, pa i mohuar, pa i përngjasuar dhe pa i shembulluar.

Teuhidi Uluhije

Veçimi i Allahut, të Madhëruar, në adhurim ose me veprat e robit.

Teuhidi Rububije

Veçimi i Allahut, të Madhëruar, në veprat e Tij, ose veçimi i Allahut, të Madhëruar, në krijimin, në sundimin dhe drejtimin e Tij.

Tre shkallët e fesë

Ihsan-Bamirësia

Është adhurimi i Allahut, të Madhëruar, sikurse ti e shikon Atë, dhe nëse nuk arrin këtë gjendje, atëherë adhuroje duke ndjerë se Ai të shikon.

Një shtyllë e vetme nën të cilën ka dy grada:

1-Adhurim sikur po e shikon Ta adhurosh sikur ti e shikon atë
2- Adhurim duke ndjerë mbikqyrjen, pra edhe nëse ti nuk e shikon, adhuroje duke ndjerë se Ai po të shikon.

Imani-Besimi

Është dëshmi me gjuhë, besim me zemër dhe punë me gjymtyrë, rritet dhe pakësohet.

Shtyllat e Besimit: 6

1-Besimi në Allahun.
2-Besimi në Engjëjt
3-Besimi në Librat
4-Besimi në të Dërguarit
5-Besimi në Ditën e Gjykimit
6-Besimi në caktimin e Allahut, i mirë dhe i keq.

Islami

Është dorëzimi ndaj Allahut, të Madhëruar, duke e veçuar në adhurim, nënshtrimi i plotë ndaj urdhërave të Tij, dhe distancimi nga idhujtaria dhe idhujtarët.

Shtyllat e Islamit: 5

1-Dy dëshmitë
2- Falja e namazit
3- Dhënia e zekatit
4-Agjërimi i Ramazanit
5-Kryerja e Haxhit

4 Llojet e ndalesave

Gjynahet e vogla

(ato që sjanë gjynahe të mëdha futen tek gjynahet e vogla, pra që nuk është përmendur për të dënim specific).Gjynahet e mëdha fshihen me kërkimin e faljes, gjynahet e vogla nëse bëhen në vazhdimësi shndërrohen në të mëdha, Profeti, alejhi selam, thotë: "Kujdesni nënçmimin e gjynaheve nëse ato grumbullohen tek personi mundet ta shkatërrojnë."

Gjynahet e mëdha

(Çdo gjynah i cili kërcënohet me dënim specifik për të) Si magjia, mosrespektimi i prindërve, kamata, imoraliteti, homoseksualiteti, gënjeshtra, pirja e alkolit, vjedhja, përgojimi, vrasja e njeriut të cilën Allahu e ka ndaluar, vetëm se me të drejtë dhe ngrënia e pasurisë së jetimit.

Shirku i vogël - Idhujtaria e vogël

(Nuk të përjashton, nuk të nxjerr nga feja) Përshembull: Të thuash: Deshi Allahu dhe ti, ose të betohesh në dikë tjetër përveç Allahut, ose si syefaqësia e pakët, ose nuskat që përmbajnë idhujtari, ose ndjellja e të keqes ose pesimizmi nëpërmjet shenjave të ndryshme, varja e medaljonit në formën e dorës ose varja e rruazave, duke besuar se këto janë shkak për tu ruajtur ose për tët larguar mësyshin.

Idhujtaria e madhe-Shirku i madh

(Të përjashton dhe të nxjerr nga Feja dhe nuk falet nëse vdes pa u penduar prej tij) Ti bësh Allahut të barabartë, e lut dikë sikur lut Allahun, ose frikësohet prej dikujt, ose shpreson prej dikujt ose do dikë sikurse do Allahun, ose i detikon dikujt një prej llojeve të adhurimeve.